

KODI ZGJEDHOR

Neni 25/2: Numërimi dhe vlerësimi i votave nga jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë dhe rezultati zgjedhor

(Shtuar me ligjin nr. 10/2025, datë 17.2.2025)

1. Fletët e votimit të dërguara nga zgjedhësit jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë në momentin e mbërritjes në KQZ regjistrohen në një regjistër të posaçëm dhe ndahen sipas zonës zgjedhore të vendbanimit më të fundit të zgjedhësit para largimit nga Shqipëria.
2. Fletët e votimit të dërguara nga zgjedhësit jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë dhe të administruara nga KQZ-ja numërohen dhe vlerësohen në vendin e numërimit të votave nga jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë të caktuar nga KQZ-ja.
3. Procesi i numërimit të tyre fillon në të njëjtin moment kur fillon numërimi i kutisë së parë me fletë votimi të zonës zgjedhore përkatëse.
4. Numërimi dhe vlerësimi i votave nga jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë administrohet nga një komision i përbërë prej 4 anëtarësh dhe sekretari, të emëruar nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve. Propozimi për 2 anëtarë bëhet nga partia më e madhe e shumicës parlamentare dhe për 2 anëtarët e tjerë propozimi bëhet nga partia më e madhe e pakicës parlamentare. Sekretari i komisionit emërohet në bazë të aplikimeve të lira dhe duhet të jetë me profesion jurist. Anëtarët dhe sekretari duhet të plotësojnë kushtet dhe kriteret e përcaktuara në nenet 30 dhe 31 të këtij Kodi. Nëse numri në listën përfundimtare të zgjedhësve nga jashtë është më i madh se 80 mijë, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve mund të ngrejë më shumë se një komision të numërimit dhe të vlerësimit të votave nga jashtë, me kushtin që vlerësimi i votave të një qarku të kryhet nga i njëjti komision.
5. Për numërimin dhe vlerësimin e votave Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve cakton grupe numërimi të përbërë nga dy anëtarë. Një anëtar propozohet nga partia më e madhe e shumicës parlamentare dhe anëtar i tjetër nga partia më e madhe e pakicës parlamentare.
6. Rregullatori, me propozimin e Komisionerit, përcakton me akt nënligjor dokumentacionin, mënyrën e plotësimit të tij dhe çdo aspekt tjetër për administrimin, vëzhgimin e procesit të numërimit, numërimin, vlerësimin e votës dhe tabelimin e rezultatit zgjedhor sipas këtij neni.